VENDIM
Nr. 313, datë 6.11.2023

MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË "SELCA ENERGJI" SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "SELCA"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 66 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2074/5 prot., datë 2.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Selca Energji' sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Selca",

konstatoi se:

- Shoqëria "Selca Energji" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1974 prot., datë 27.7.2023, paraqiti aplikimin për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC "Selcës" nga 1.6 mw në 1.98 mw, pra për modifikimin e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 39, datë 5.5.2010, të ndryshuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 9.8.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për arsye të rritjes së kapacitetit të HEC "Selca" nga 1,6 mw në 1,98 mw.

- ERE bëri njoftimin në medien e shkruar për këtë vendimmarrje, e cili është botuar në datat 10.8.2023 dhe 11.8.2023 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve të mundshme nga të tretët (data 19.8.2023) deri në këtë vendimmarrje nuk rezulton të ketë të tilla. Ky njoftim është botuar dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Ndërsa, me shkresën nr. 1974/4 prot., datë 22.8.2023, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim dokumentacioni.

- Bordi i ERE-s, me vendim nr. 269, datë 11.9.2023, vendosi zgjatjen e afatit për vendimmarrjen me 60 (gjashtëdhjetë) ditë për aplikimin e shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k., për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Selca". ERE, me shkresën me nr. 1974/11 prot., datë 13.10.2023, njoftoi shoqërinë mbi zgjatjen e afatit për të vendimmarrjes.

- ERE, në konstatimet e vendimit nr. 269, datë 11.9.2023, në zbatim të nenit 15, pika 4, germat "d", "e" dhe "f", të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, vlerësoi se nevojitej miratimi/qëndrimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në lidhje me trajtimin e rasteve për ndryshimin e kapacitetit të centraleve të prodhimit të energjisë elektrike të privatizuara; miratimi/qëndrimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), mbi rritjen e kapacitetit të instaluar, si dhe miratimi/qëndrimi i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), në rast se leja për përdorimin e burimit ujor vlen dhe për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Selca" me kapacitet të shtuar prej 380 kw.

- Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s u vendos me qëllim marrjen e një miratimi/qëndrimi të mundshëm nga MIE, AKM-ja dhe AMBU-ja, në lidhje me rritjen e kapacitetit të HEC "Selca" me 380 kw dhe modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Selca". Për qëllime të vendimmarrjes nr. 269/2023, ERE iu drejtua me shkresën nr. 1974/3 prot., datë 18.8.2023, MIE-s, me

shkresën nr. 1974/8 prot., datë 22.9.2023, iu drejtua AKM-së, me shkresën nr. 1974/9 prot., datë 22.9.2023, iu drejtua AMBU-së dhe për dijeni shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k.

- Për sa më sipër, AKM-ja, me shkresën nr. 1974/12 prot., datë 23.10.2023, ka informuar se në përgjigje të shkresës sonë me nr. 1974/8 prot., datë 22.9.2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është shprehur me shkresën me nr. 5984/1prot., datë 13.10.2023, se ndryshimi i fuqisë në projekt duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së paraprake, sipas përcaktimeve të kreut I, të VKM-së nr. 686, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave dhe të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës, së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe të deklaratës mjedisore", të ndryshuar.

- Rezulton se, deri në këtë vendimmarrje, nuk kemi një përgjigje nga MIE dhe AMBU-ja, për sa kërkohet me shkresat përkatëse nisur nga ERE.

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet, se: "Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër ("çështja paraprake"), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë."

- Për sa më sipër vlerësohet që të pezullohet vendimmarrja e Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në depozitimin e VNM-së paraprake dhe miratimit/qëndrimit përkatës nga MIE dhe AMBU-ja.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri kur të depozitohet në ERE VNM-ja paraprake, miratimi/qëndrimi përkatës i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, ku të përcaktojë nëse leja ekzistuese vlen dhe për kapacitetin e shtuar prej 380 kw, si dhe qëndrimin/miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Selca Energji" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti